

Departamenti i Prokurimit

Prishtina: datë, 27.05.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.05.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik INTRAST, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi dhe modernizimi i semaforëve, montimi i paneleve ndriqese në vendkalime dhe matësve të shpejtësisë”**, me Nr. të Prok: **616 21 025 521** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të INTRAST të dt. 24.05.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit “ **Ndërtimi dhe modernizimi i semaforëve, montimi i paneleve ndriqese në vendkalime dhe matësve të shpejtësisë**, me Nr. **616 21 025 521**, kundër [Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK –së, të datës 19.05.2021 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. [Vërtetohet] vendimi i AK për [dhënien e kontratës] të publikuar me datë: **19.05.2021**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar pretendimet tuaja dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimi se OEik "ITK" se nuk ka ofruar certifikaten për standardin EN 12352 nuk qëndron, sepse


- OE-ik ka ofruar Certifikatën për standardin EN 12352 (si standard unifikues që përfshihen të gjitha brenda tijë), ku për këtë standard është dhënë edhe sqarim shtesë (pyetja është bërë nga nje OE). Nga kjo nënkuptohet se sipas standardit të kërkuar të gjitha kriteret e kërkuara janë brenda standardit, kurse dimensionet e ofruara janë poashtu brenda standardit. Ne kemi kërkuar që dimensionet të mos jenë nën kriteret e paraqitura në specifikime teknike.
- Dimensionet e panelit sinjalizues në kërkesën sipas karakteristikave teknike është në përputhje të plotë sipas dimensioneve minimale 1300 x 1000 mm (kërkesa e jonë ka qenë 130 x 100 cm që është e njëjtte), në panelin sinjalizues nuk është cekur materiali që të jetë polikarbonat, mirëpo vetëm folia të jetë reflektuese, diamond grade, po e cila I plotëson kriteret.
- Kurse sa I përket materialit polikarbonat është definuar në bazë të standardit EN 12352 e cila është kërkuar vetëm për drita sinjalizuese.
- Standardi EN 60529 i prezantuar nga operatori ekonomik I plotëson kriteret teknike të shkallës mbrojtëse IP 00 deri në IP 68 si dhe temperatura është nga -40 gradë deri në +60 gradë, që d.m.th. jemi brenda kriterëve teknike të kërkuara; dhe
- Ndërsa sa I përket pretendimit lidhur me marrëveshjen për shfrytëzimin e rimorkios sinjalizuese është vërtetuar në teren nga Komisioni për Vlerësim se e posedon këtë pajisje me dokumentacion.

Ng keto sqarime është e qarte se tenderuesi i rekomanduar për kontratë i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe se pretendimet tuaja janë të pa bazuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit